

REPUBLIKA E SHOIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
REKTORATI

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2020

## Raporti i Projekt Zbatimit

Objekti: "Projekti i rehabilitimit për objektin 6-kate, me vendndodhje në Rr. "Jordan Misja", TIRANË

Porositës: "Agjencia Shtetërore e Kadastrës", "Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve"

Për Universitetin Politeknik të Tiranës

ADMINISTRATORI  
Z. BESMIR ALI

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "NënëTereza", Nr.4, Tiranë,  
Tel/Fax: +355 4 2227914,  
web: www.upt.al

# Godina e "ASHK&DPT"

Tiranë Shtator 2020

## I. Përmbajtja

<b>I. HYRJE</b>	<b>5</b>
<b>II. VLERËSIMI I GJENDIES AKTUALE TË STRUKTURES</b>	<b>6</b>
2.1 HYRJE	6
2.2 PARIMET E PERGJITSHME	6
JETËGJATËSIA E PROJEKTIMIT TË NDËRTESAVE (MOSHA E TYRE)	7
VLERËSIMET E SOTME TË RREZIKUT SIZMIK	7
NDRYSHIMET NË KODET E PROJEKTIMIT	7
DËMTIMET QË KANË PËSUAR NDËRTESAT	7
TË DHËNA, STUDIME DHE PROVA LABORATORIKE	8
2.3 PERSHKRIMI STRUKTURES	9
TE PERGJITHSHME.	9
2.4 GJENDIA EKZISTUESE (AKT KONSTATIM PAS TERMETIT).	11
2.5 IDENTIFIKIMI DHE NJOHJA GJEOMETRIKE	14
2.6 IDENTIFIKIMI DHE NJOHJA E ARMIMIT DHE DETAJEVE STRUKTURORE	15
2.7 IDENTIFIKIMI DHE NJOHJA E KARAKTERISTIKAVE TE MATERIALEVE	15
IDENTIFIKIMI.	15
TESTIMI	15
<b>III. VLERËSIMI I RREZIKUT SIZMIK TË STRUKTURES</b>	<b>18</b>
3.1 TË DHËNAT HYRËSE TË NEVOJSHME	18
3.2 NIVELI I NJOHJES	19
3.3 PERCAKTIMI INPUTIT SIZMIK	21
3.4 ANALIZA LINEARE E STRUKTURES SIPAS KUSHTEVE EUROPIANE TE PROJEKTIMIT	22
TE PERGJITHSHME	22
REZULTATET ANALIZES SIZMIKE TE MODELIT LINEAR SIPAS SOFTWARE-IT "AUTODESK ROBOT STRUCTURAL ANALYSIS".	23
3.5 KONKLUZIONE PER ANALIZAT LINEARE	28
3.6 ANALIZA JOLINEARE E STRUKTURES	30
HYRJE	30
3.7 KONKLUZIONE PER ANALIZAT JOLINEARE	39
3.9 KONTROLLI I MEKANIZMAVE KINEMATIKE SIPAS EC8/3, FEMA	40
<b>IV. VLERËSIMI I THEMELEVE TE STRUKTURES</b>	<b>41</b>
4.1 AFTESIA MBAJTESE E TERRENIT	41
<b>V. VLERËSIMI I SKENAREVE TE NDERHYRJES NË STRUKTURE</b>	<b>43</b>
IDENTIFIKIMI I SKENAREVE	43

<b>VI. PER Fundime</b>	<b>44</b>
<b>VII. PROJEKTI NDERHYRJEVE</b>	<b>45</b>
7.1 IDENTIFIKIMI I SKENARAVE TE NDERHYRJES	45
7.2 ANALIZA E STRUKTURES ME NDERHYRJE PERFORCUESE SIPAS SKENARI II/1	45
7.3 ANALIZA E STRUKTURES ME NDERHYRJE PERFORCUESE SIPAS SKENARI II/2	48
POZICIONIMI I SHUARESVE.	48
MODEL ASHK TIRANE. PLASTICITET TE PERQENDRUAR.	51
MODELI ME PLASTICITET TE SHPERNDARE.	53
7.4 KONKLUZIONE PER ANALIZAT JOLINEARE TE STRUKTURES SE PERFORCUAR	56

## Lista e figurave

Figure 1. Pozicioni godines.	5
Figure 2. Plani strukturave ekzistues kuota 4.30	9
Figure 3. Plani strukturave ekzistues kuota 6.25	10
Figure 4. Plani strukturave ekzistues tip	10
Figure 5. Pozicionet e provave	16
Figure 6. Harta e Akseleracionit Maksimal ne truall shkembor per probabilitet 10% / 50 vjet ose 475 vjet periode perseritje, llogaritur me relacionet e shuarjes Sadigh etj., 1997 dhe Spudich etj., 1999 (Aliaj etj., 2010).	21
Figure 7. Spektri i reagimit elastik dhe llogarites per $q=3.1$	22
Figure 8. Spektri I zhvendosjeve llogaritese	22
Figure 9. Modeli sipas software-it "Autodesk Robot Structural Analysis".	23
Figure 10. Pozicionet e QM dhe QSh per katin tip	25
Figure 11. Pozicionet e QM dhe QSh per katin e gjashte	25
Figure 12. Zhvendosjet sipas drejtimit x.	26
Figure 13. Zhvendosjet sipas drejtimit y.	26
Figure 14. Armimi i elemeneve.	27
Figure 15. Klasifikimi demtimeve sipas FEMA 306	29
Figure 24. Modeli plan 2D me plasticitet te shperndare (PSh)	30
Figure 26. Spektrat sipas kerkeses sizmike per cdo tip te gjendies kufitare	31
Figure 27. Shembull modelimi i kollones ne analizat me PSh	31
Figure 28. Modelimi materialit jolinear ne analizat 3D me plasticitet te shperndare (PSh)	32
Figure 30. Zhvendosjet ne modelin PSh per step 2 (max)	33
Figure 31. Elementet qe tejkalohe kriteri performances-Shkaterrim i betonit te shtrenguar (crush_conf).	34
Figure 32. Elementet qe tejkalohe kriteri performances- Tejkalim i $\epsilon_y$ ne shufrat e celikut (yield)-	34
Figure 33. Elementet qe tejkalohe kriteri performances- Shkaterrim i betonit te pashtrenguar (crush_unconf).	35
Figure 34. Elementet qe tejkalohe kriteri performances- Shkaterrim i betonit te shtrenguar (crush_conf). Frakture totale elementit (fracture)	35
Figure 36. Aftesia mbajtese e tabanit per aksin B dhe D.	41
Figure 36. Aftesia mbajtese e tabanit per aksin C..	42

**Lista e fotove**

<i>Foto 1. Carje ne bashkim muresh.....</i>	<i>11</i>
<i>Foto 2. Carje ne mure mbushes.....</i>	<i>12</i>
<i>Foto 3. Carje ne mure mbushes.....</i>	<i>13</i>
<i>Foto 4. Carje ne mure mbushes.....</i>	<i>14</i>

**Lista e tabelave**

<i>Table 1. Karakterizimi i niveleve te njohjes sipas ec8/3 .....</i>	<i>19</i>
<i>Table 2. Numri I provave per cdo nivel inspektimi .....</i>	<i>20</i>
<i>Table 3. Rezultatet e analizes modale .....</i>	<i>24</i>
<i>Table 4. Rezultat e analizes strukturale. QM, QSh, jashtegendersite .....</i>	<i>24</i>
<i>Table 5. Rezultat e analizes strukturale. Zhvendosjet dhe driftet.....</i>	<i>24</i>

## I. HYRJE

Sipas kontratës Nr 150/2, datë 03.02.2020 me "Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe "Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve." u realizua vlerësimi strukturor inxhiniero-sizmologjik i Godinës ekzistuese 6KT të ndodhur në Tiranë Rr. "Jordan Misja" me koordinatat 484048.0, 4577887.0 sipas sistemit KRGJSH



Figure 1. Pozicioni i godinës.

### Kontrata ka si objekt:

- a. Realizimin e provave për njohjen strukturore
- b. Vlerësimin sizmik të strukturës ekzistuese sipas metodologjisë së përcaktuar në kodin EC8/3 si dhe dokumentat e "FEMA" dhe "ATC"
- c. Hartimin e projektit të ndërhyrjeve sipas përcaktimeve të EC

## II. VLERËSIMI I GJENDIES AKTUALE TË STRUKTURES

### 2.1 Hyrje

Metodologjia e përgjithshme sipas rekomandimeve të shprehura në Eurokodin 8/3, dokumentet FEMA dhe ATC bazohet mbi këto etapa:

- Mbledhja e të dhënave ekzistuese për strukturën
- Mbledhja e të dhënave mbi kriteret e projektimit sismik të ndërtesës (në kohën e projektimit të saj);
- Identifikimi i të dhënave gjeometrike karakteristike për strukturën dhe detajet përkatëse (Armimi)
- Identifikimi i karakteristikave të materialeve
- Mbledhja e të dhënave mbi dëmtimet strukturore të tanishme ose të mëparshme (nëse ka), duke përfshirë riparimet e mundshme që janë kryer në kohë.
- Rivlerësimi i ngarkesave të ushtruara në rastet kur ndërtesa shërben për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në kohën e projektimit duke konsideruar edhe klasën e rëndësisë së ndërtesës.
- Vlerësimi strukturor nepermjet analizave lineare sipas kriterëve të Eurokodeve
- Vlerësimi strukturor nepermjet analizave jolineare (përfshirë edhe vlerësimin e tabanit/themeleve nëse është e nevojshme)
- Vlerësimi i kapacitetit të elementeve strukturor
- Përfundime

### 2.2 Parimet e përgjithshme

Nevoja për riaftësim strukturor

Arsyet kryesore të kryerjes së vlerësimit strukturor të ndërtesave ekzistuese janë:

- jetëgjatësia e projektimit të ndërtesave (mosha e tyre)
- vlerësimet e sotme të rrezikut sismik;
- ndryshimet në kodet e projektimit nga koha e ndërtimit deri sot;
- dëmtimet e ndryshme që kanë pësuar ndërtesat ndër vite.
- nderhyrjet arkitektonike të planifikuara

### Jetëgjatësia e projektimit të ndërtesave (mosha e tyre)

Ndërtesat që janë objekt i këtij vlerësimi janë relativisht të vjetra. Nëse mbajmë parasysh kërkesat e kushteve të vjetra të projektimit, apo edhe ato të kushteve të sotme, jetëgjatësia e projektimit të ndërtesave me përdorim të gjerë nga publiku është 50 deri në 100 vite. Kjo jetëgjatësi përcaktohet si një periudhë kohore gjatë së cilës struktura është e aftë të kryejë funksionin e saj pa pasur nevojë për ndërhyrje strukturore të rëndësishme. Ndërtesa e Infosoft sh.p.k është pak më shumë se 23 vite, prandaj nuk lind nevoja për vlerësim strukturor të saj për të gjykuar nëse është e nevojshme të kryhen ndërhyrje për zgjatjen e kohës së përdorimit deri në ndërhyrjet e ardhshme strukturore.

### Vlerësimet e sotme të rrezikut sizmik

Harta e parë sizmike e Shqipërisë daton në vitin 1952. Që nga viti 1952, për shkak të pasurimit të vazhdueshëm me të dhëna, rreziku sizmik është vlerësuar gjithmonë në rritje. Këtu ka rëndësi të përmendet fakti që për ndërtesat që janë ndërtuar përpara vitit 1979, kushtet teknike kanë qenë të vjetra, por edhe harta e rajonizimit sizmik ka pasur vlera të ulëta të intensiteteve sizmike të tërmeteve të pritshëm.

Punime të viteve të fundit (si p.sh. ai i UNDP Albania dhe ai i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë) tregojnë për rritje të mëtejshme të vlerave që përfaqësojnë rrezikun sizmik. Në mënyrë të përafërt, botimet e sotme e vlerësojnë rreth 0.25-0.27g nxitimin referencë në truall të fortë në Tiranë për një periode kthimi 475 vite.

*Duke u nisur nga ky fakt ndërtesa e ASH&DPT ka nevojë për vlerësim strukturor.*

### Ndryshimet në kodet e projektimit

Në fushën e inxhinierisë civile dhe asaj të tërmeteve janë bërë zhvillime shumë të mëdha që nga koha kur ndërtesat ekzistuese janë projektuar dhe zbatuar. Kushtet Teknike të Projektimit në fuqi në vendin tonë (KTP-78 dhe KTP-N.2-89) datojnë që prej vitit 1978, pra ato janë tashmë 42 dhe 31 vjeçare. Megjithatë përmirësimi i fundit i KTP-78 i bërë në vitin 1989 (KTP-N.2-89) është një kod projektimi që pasqyron mirë kërkesat e kohës së tij, ai qëndron relativisht larg në shumë prej kërkesave bashkëkohore të projektimit sizmik. Rregullat që përmban KTP-N.2-89 janë më shtrënguese se ato të kushteve teknike të mëparshme, por Eurokodet strukturore, procesi për adoptimin e të cilëve ka nisur tashmë edhe për vendin tonë, shprehin kërkesa akoma më të mëdha për ndërtesat.

Në këto kushte, arrihet në përfundimin se ndërtesat që janë projektuar me kushte teknike që ofrojnë një siguri të kufizuar në krahasim me kushtet teknike në fuqi, e akoma më të reduktuar në krahasim me kërkesat bashkëkohore (p.sh. ato të Eurokodeve Strukturore) duhet detyrimisht ti nenshtrohen rivlerësimit strukturor.

*Duke u nisur nga ky fakt ndërtesa e ASH&DPT ka nevojë për vlerësim strukturor.*

### Dëmtimet që kanë pësuar ndërtesat

Në ndërtesat ekzistuese vihen re dëmtime të ndryshme të zhvilluara ndër vite. Ato mund të kenë ndodhur nga tërmetet e mëparshëm, nga cedimi i themeleve, nga dëmtimet e ndryshme nga përdorimi etj. Për të saktësuar ndikimin e këtyre dëmtimeve në kapacitet dhe në reagimin e strukturave në situatë sizmike është i nevojshëm vlerësimi strukturor i këtyre ndërtesave.

*Duke u nisur nga ky fakt ndertesa e ASHK&DPT nuk ka nevojë për vlerësim struktural.*

### **Të dhëna, studime dhe prova laboratorike**

Me qëllim kryerjen e një vlerësimi struktural dhe dhënien e rekomandimeve për ndërhyrje të mundshme strukturore në ndërtesat ekzistuese nevojitet të mbledhen të dhënat e mëposhtme:

- **gjeometria dhe hollësitë strukturore;**

Gjeometria dhe hollësitë strukturore duhet të merren nga një kombinim midis të dhënave të paraqitura në projektet origjinale dhe vizitave në vend që do shërbejnë për verifikimin e përputhshmërisë me projektet origjinale. Për të gjitha ndërtesat, nevojitet të bëhen vizatime të sakta të gjendjes ekzistuese, të cilat evidentojnë ndryshimet e mundshme që mund të jenë bërë gjatë zbatimit dhe gjatë periudhës së gjatë të përdorimit të ndërtesave. **Rilevimi i plotë i gjendjes ekzistuese është detyrë e Konsulentit dhe duhet të paraqitet në fletë të vecanta në projektin struktural.**

- **të dhënat mbi materialet;**

Meqenese janë kryer prova të meparshme mbi materialet (kemi një dosje të plote të zbatimit) Konsulenti do të kryejë vetëm prova shtese gjatë fillimit të punimeve (që i shikon të arsyeshme). Hartimi i planit të provave dhe sigurimi i tyre është detyrë e Konsulentit.

- **të dhënat gjeologo-inxhinierike, hidrologjike dhe sizmike;**

Këto të dhëna duhet të ballafaqohen me studimet e vjetra (nëse ato gjenden) dhe të vihen në pah ndryshimet e mundshme në studimet e kryera në kohë të ndryshme. Fillimisht nevojitet të përpilohet një plan provash laboratorike për përcaktimin e parametrave gjeoteknikë të nevojshëm për verifikimet strukturore. Veçanërisht në rastet kur ka cedim të themeleve, plani i provave gjeologo-inxhinierike duhet të jetë i zgjeruar. Nisur nga rëndësia e këtyre ndërtesave, nevojitet gjithashtu një studim sizmik ose vërtetim për kushtet sizmike të vendit ku ato janë ndërtuar. **Ne rastin tone kemi shfrytëzuar studime gjeologjike që janë kryer vitet e fundit në zone.**

- **inspektimi i gjendjes ekzistuese;**

Përpara fillimit të vlerësimit të plotë struktural, Konsulenti duhet të hartojë një material teknik paraprak të bazuar në vizitat në vend. Këto vizita kanë për qëllim evidentimin e mangësive të mundshme strukturore, deformimeve, çarjeve apo problemeve të tjera që mund të vëzhgohen në mënyrë të drejtpërdrejtë.

- **Historia e dëmtimeve nga tërmete të shkuar;**

Të dhënat lidhur me dëmtimet që kanë pësuar ndërtesat në ngjarje sizmike të ndodhura në të shkuarën dhe riparimet që mund të jenë bërë duhet të mbledhen dhe të analizohen për të gjykuar mbi historinë e reagimit sizmik të këtyre strukturave.

**Konsulenti duhet të plotësojë mbledhjen e të dhënave për të arritur njohje të nivelit KL3 (njohje e plotë sipas EN 1998-3).** Vetëm në rast se kjo nuk është e mundur (për shkak të mungesës së plotë apo të pjesshme të të dhënave), do lejohet një nivel njohjeje më i ulët i strukturës, shoqëruar me argumentet përkatëse në raportin struktural.



## Godina "AShK&DPT"

### 2.3 Pershkrimi struktures

#### Te pergjithshme.

Godina eshte nje strukture beton/arme me tip struktural miks, rama b/a parafabrikat me mure mbajtese tulle. Megjithate per shkak te menyres se punes se muratures mbajtese te tulles sjellja e saj nuk l pergjigjet plotesisht sjelljes si "dual system", frame or wall – equivalent. Godina perbehet nga 5 pjese te ndara me fuge ndermjet tyre, 3 pjese jane 1 kateshe dy pjese jane 6 Kateshe. Njera nga pjeset 6 KT eshte shkalla anesore. Godina kryesore ka 6KT mbi toke me dy pjese anesore 1KT. Kollonat jane me permasa drejtekesdeshe 40x90, 40x70, 40x60. Traret jane 40x70, 35x90, 30x90. Soletat jane te pararegatitura dhe pjeserisht te monolitizuara ne vend me shtrese b/arme 3-5cm. Figurat ne vazhdim paraqesin ndarjet e godines dhe planet e strukturave te pjese kryesore.




Figure 2. Plani strukturave ekzistues kuota 4.30




Figure 3. Plani strukturave ekzistues kuota 6.25




Figure 4. Plani strukturave ekzistues tip

#### 2.4 Gjendia ekzistuese (Akt Konstatim pas termetit).

Gjendia ekzistuese e godines nga vëzhgimet rezulton jo e kenaqshme. Ka çarje të shumta në mure ndares tulle dhe bashkime muresh. Në elementet struktural, soleta, trare nuk janë dalluar demtime apo çarje (vetëm në disa soleta në KT 0 është vërejtur plasaritje sipas bashkimit të paneleve të parapregatitur). Në kollona në një të bashkimit të seksionit parafabrikat janë vërejtur demtime të suvatimit dhe deformime të pllakave bashkuese.

Figurat në vazhdim ilustrojnë disa verifikime të kryera pas termetit të Durrësit të 26 Nëntorit.



Foto 1. Çarje në mure mbajtës.



Foto 2. Carje ne mure mbushes.




Foto 3. Carje ne mure mbushes.



Foto 4. Carje ne mure mbushes.

## 2.5 Identifikimi dhe njohja gjeometrike

Nga porositesit na u vu ne dispozicion projekti i plote strukturor te realizuar nga Instituti Projektimit ne vitin 1985.

Nga vizitat ne objekt jane identifikuar te gjithë elementet strukturore. Elementet strukturore jane identifikuar me vëzhgim dhe pakometer. Keta elemente strukturore jane:

- Themele plint dhe te vazhduar (nuk verifikohen dot)
- Kollona b/arme drejtekendeshe 40x70, 40x60, 40x90 si dhe kollona me te vogla per pjeset 1KT
- Muret mbajtes jane me trashesi 25cm kryesisht me tulle silikat
- Soleta b/arme kryesisht dy tipe. Soleta - panel i parapregatitur ne forme "U" 98x40cm, dhe soleta panel i parapregatitur drejtekendor me 2 ose 3 bira me artesi 22cm
- Shkalle b/arme derdhura ne vend monolite 25cm.
- Traret jane te formave dhe permasave te ndryshme.

Figurat ne vazhdim paraqesin disa nga skicat permbledhese per njohjen gjeometrike (dhe armimit)

Permasat e të gjithë elementeve janë verifikuar në vend. Elementet strukturore kanë ndryshim permasash në lartësi.

Dosja e zbatimit të godinës është e plotë, e rregullt me të gjithë informacionin e nevojshëm për njohjen gjeometrike.

**Nga pikepamja gjeometrike për strukturën konsiderohet se kemi informacion të saktë dhe të plotë.**

## 2.6 Identifikimi dhe njohja e armimit dhe detajeve strukturore

Detajet për realizimin e testeve të njohjes së armimit dhe detajeve strukturore janë raport me vete.

Me testet e realizuara janë verifikuar këto elemente:

Kollona	2 kollona cdo kat	Prova	Sk, Pa, US
Trau	2 trare cdo kat	Prova	Sk, Pa, US
Soleta	2 soleta	Prova	Sk, Pa, US
Bashkime/nyje	2 +2 kollona, 2Trare	Prova	Saldimi dhe detajimi nyjes

**Nga pikepamja armimit dhe detajeve për strukturën konsiderohet se kemi informacion të paket.**

## 2.7 Identifikimi dhe njohja e karakteristikave të materialeve

### Identifikimi.

Materialet që janë përdorur në godinë janë:

- Tulle me bira horizontale për muraturë jostrukturore
- Beton për plinta M200 (Sipas projektit)
- Beton për kollona, trare dhe soleta M300 (Sipas projektit)
- Çelik për beton Ç-27-S me  $R_s=2400 \text{ kg/cm}^2$  (Sipas projektit)
- Çelik për beton Ç-25-S me  $R_s=2100 \text{ kg/cm}^2$  për stafat (Sipas projektit)

### Testimi

Për të kontrolluar gjendjen aktuale të materialëve të përdorura për elementet strukturore u realizuan teste në objekt. Testet e kryera në objekt janë:

- Teste sclerometrike
- Teste ultrasonike
- Teste skaner 3D

Planimetritë në vazhdim japin pozicionet dhe testet e kryera.

Figure 5. Pozicionet e provave

Te dhënat e detajuara të çdo testi janë paraqitur në raport me vete. Me pashtë po japim vetëm përmbledhjen e rezultateve të cilat janë përdorur për analizat.

Nga analizimi i të dhënave të testeve kemi këto rezultate:

### Betoni

**Betoni nisur nga projekti dhe matjet është klasifikuar- Klasa C20/25**

-Për të gjitha elementet struktural prej betoni

Pesha e vetjake

$$\rho = 2500 \text{ kg/m}^3$$

Rezistenca kubike në shtypje e betonit

$$f_{ck, \text{cube}} = 250 \text{ daN/cm}^2$$

Rezistenca në shtypje prizmatike e betonit

$$f_{ck} = 200 \text{ daN/cm}^2$$

Moduli i elasticitetit

$$E_c = 310000 \text{ daN/cm}^2$$

Rezistenca në tërheqje të betonit

$$f_{ctm} = 22 \text{ daN/cm}^2$$

$$f_{ctk, 0.05} = 15.0 \text{ daN/cm}^2$$

Rezistenca llogaritore në shtypje

$$f_{cd} = 130 \text{ daN/cm}^2$$

Shformimi kufitar

$$\varepsilon_{cu1} = 0.0035$$

Koeficienti i Puasonit (beton me çarje)

$$\eta = 0.1$$



Koeficienti i sigurisë pjesëshme

$$\gamma_c = 1.5$$

### Armatura shufra Çeliku

Shufrat e çelikut janë marrë me karakteristikat e mëposhtme. Keto karakteristika janë marrë nga karakteristikat mesatare të çelikut që qarkullonte në vend të vitet 1995-2000.

Sforcimet maksimale në terheqje

$$f_{tk} \approx 2700 \text{ daN/cm}^2$$

Sforcimet pragut të rjedhshmerisë (Sforcimet kufitare në terheqje)

$$f_{yk} \approx 2300 \text{ daN/cm}^2$$

Moduli i elasticitetit

$$E_c = 2100000 \text{ daN/cm}^2$$

Koeficienti i zgjatjes relative > 10%

$$A_s = 15\%$$

$$(f_t / f_y)_k = 1.20$$

Koeficienti i sigurisë së pjesëshme

$$\gamma_s = 1.15$$

Rezistenca e lejuar

$$f_{yd} = 2100 \text{ daN/cm}^2$$

**Nga pikepamja e njohjes së materialit konsiderohet se kemi informacion të paket**

### III. VLERËSIMI I RREZIKUT SIZMIK TË STRUKTURES

Per vleresimin e struktures do te realizojme analizat e meposhtme:

1. Analiza lineare me spekter reagimi dhe faktor sjellje sipas sipas EC8
2. Analiza jolineare statike 3D me plasticitet te perqendruar PO

Ne vazhdim jepen detajet per analizat dhe te dhenat e nevojshme per kryerjen e tyre.

#### 3.1 Të dhënat hyrëse të nevojshme

Informacioni për vlerësimin strukturalor duhet të përfshijë pikat e mëposhtme.

- a) Identifikimin e sistemit strukturalor dhe përputhshmërinë e tij me kriteret e rregullsisë të EN 1998-1: 2004. Të dhënat për ndryshimet e mundshme strukturore që nga koha e ndërtimit.
- b) Identifikimin e tipit të themeleve të ndërtesës.
- c) Identifikimin e kushteve të truallit sipas kategorizimit të bërë në EN 1998-1: 2004, **3.1**.
- d) Informacion për përmasat e përgjithshme dhe vetitë e seksioneve tërthore të elementeve të ndërtesës si dhe vetitë mekanike dhe gjendja e materialeve përbërëse.
- e) Informacion rreth defekteve të identifikueshme të materialeve dhe detajimit të papërshtatshëm.
- f) Informacion mbi kriteret e projektimit sizmik që janë përdorur në projektimin fillestar, përfshirë vlerën e faktorit zvogëlues (faktorit  $q$ ) të forcës sizmike, nëse është përdorur.
- g) Përshkrimin e përdorimit aktual dhe/ose të planifikuar të ndërtesës (duke identifikuar edhe klasën e rëndësisë së saj, siç përshkruhet në EN 1998-1: 2004, **4.2.5**).
- h) Rivlerësimin e veprimeve që ushtrohen duke mbajtur parasysh përdorimin e ndërtesës.
- i) Informacion rreth tipit dhe shtrirjes së dëmtimeve strukturore në të kaluarën dhe të tashmen, nëse ka, përfshirë masat e mëhershme të riparimit.

### 3.2 Niveli i njohjes

Me qëllim zgjedhjen e tipit të pranueshëm të analizës dhe të vlerave të përshtatshme të faktorëve të besimit, EC8/3 përcakton tri nivelet e mëposhtme të njohjes:

- KL1: Njohje e kufizuar
- KL2: Njohje normale
- KL3: Njohje e plotë

Marrëdhënia ndërmjet niveleve të njohjes, metodave të përdorshme të analizës si dhe faktorëve të besimit tregohet në Tabelën e mëposhtme.

Table 1. Karakterizimi i niveleve të njohjes sipas EC8/3

Niveli i njohjes	Gjeometria	Detajet	Materialet	Analiza	CF
KL1	Nga vizatimet e përgjithshme të ndërtimit me rilevim <b>pamor</b> të pjesshëm (me kampione)  ose nga rilevim i <b>plotë</b>	Projektim i simuluar në përputhje me praktikën e kohës dhe nga inspektimi <b>i limituar in-situ</b>	Vlera të pranueshme në përputhje me standardet e kohës kur është ndërtuar dhe nga prova të <b>limituara in-situ</b>	LF-MRS	$CF_{KL1}$
KL2		Nga vizatimet fillestare të përfunduar të ndërtimit me inspektim të <b>limituar in-situ</b> ose nga inspektimi <b>i zgjeruar in-situ</b>	Nga specifikimet e projektit origjinal me prova të <b>limituara in-situ</b> ose nga prova të <b>zgjeruara in-situ</b>	Të gjitha	$CF_{KL2}$
KL3		Nga vizatimet fillestare të detajuara të ndërtimit me	Nga raportet origjinale të provave shoqëruar me prova të	Të gjitha	$CF_{KL3}$

		inspektim të limituar <i>in-situ</i> ose nga rilevim gjithëpërfshirës <i>in-situ</i>	limituara <i>in-situ</i> ose nga prova gjithëpërfshirëse <i>in-situ</i>		
--	--	--	---	--	--

Ne baze të informacionit të marre dhe të testuar si dhe faktit që struktura është me elemente parafabrikat që prodhohen në kushte të një kontrolli të lartë, rezulton që objekti i përgjigjet nivelit të dytë të njohjes, KL2 sipas përcaktimeve të Eurokodit 8/3. Për këtë nivel njohje duhet të aplikohet koeficienti i besueshmërisë  $CF=1.2$ . Shpjegimi më poshtë i marre nga EC8/3 shpjegon kriteret e zgjedhjes.

KL2 i përket shkallës së mëposhtme të njohjes:

- i) *gjeometria*: gjeometria e përgjithshme e strukturës dhe përmasat e elementeve njihen ose (a) nga një rilevim i imtësishëm ose (b) nga vizatimet e përgjithshme të projektit, të përdorura për ndërtimin fillestar si dhe për ndryshimet që mund të jenë kryer më vonë. Në rastin (b), këshillohet që të kontrollohen në vend një sasi e mjaftueshme përmasash si në gjeometrinë e përgjithshme ashtu edhe në përmasat e elementeve; nëse ka mospërputhje domethënëse me vizatimet e përgjithshme të ndërtimit, këshillohet të kryhet një kontroll më i plotë i përmasave.
- ii) *detajet*: detajet strukturore njihen ose nga një inspektim i zgjeruar *in-situ* ose nga vizatimet e paplota të ndërtimit. Në rastin e fundit, këshillohet të kryhen inspektime të limituara *in-situ* në elemente më kritike, me qëllim që të verifikohet se informacioni i disponueshëm i përgjigjet situatës faktike.
- iii) *materialet*: informacioni në lidhje me vetitë mekanike të materialeve të ndërtimit gjendet ose nga provat e zgjeruara *in-situ* ose nga specifikimet në projektin fillestar. Në rastin e fundit, këshillohet të kryhen prova të limituara *in-situ*.

Numri i nevojshëm i provave të çdo tipi duhet të merret sipas tabelës së mëposhtme.

Table 2. Numri i provave për çdo nivel inspektimi

	Inspektim (i detajeve)	Provat (e materialeve)
	Për çdo tip elementi parësor (tra, kolonë, mur)	
Niveli i inspektimit dhe i provës	Përqindja e elementeve të cilëve u kontrollohen detajet	Numri i mostrave të materialit për kat
I limituar	20	1
I zgjeruar	50	2
Gjithëpërfshirës	80	3

### 3.3 Percaktimi inputit sizmik

Inputi sizmik është marrë në bazë të studimit sizmologjik. Studimi sizmologjik është hartuar për parametra sizmik të zonës dhe përfaqësit sipas vlerësimeve të riskut probabilitar sizmik dhe hartave të PGA të dy grup autoreve. (Aliaj et al. dhe Duni et al.) Për analizat në "software" janë përdorur spektrat e projektimit të nxjerre nga ky studim

Studimi është dhënë si raport me vete prandaj me poshtë po paraqesim vetëm një nga hartat e përgjithshme të PGA.




Figure 6. Harta e Akseleracionit Maksimal në truall shkembor për probabilitet 10% / 50 vjet ose 475 vjet periode perseritje, llogaritur me relacionet e shuarjes Sadigh etj., 1997 dhe Spudich etj., 1999 (Aliaj etj., 2010).

### 3.4 Analiza lineare e strukture sipas kushteve Europiane te projektimit

#### Te pergjithshme

Meqenese kemi projektet ekzistuese te realizuara sipas kushteve Shqiptare te Projektimit KTP per krahasim kemi realizuar projektimin linear me ane te software-it "Autodesk Robot Structural Analysis" sipas rekomandimeve te EC2, EC8/1 dhe ngarkimit sizmik sipas procedurave llogaritese te EC8/1 dhe rekomandimeve te tjera Europiane. Analizat jane bere per dy gjendie per gjendien kufitare te sherbimit me termet llogarites me periode kthimi 95vjet dhe gjendien kufitare te fundme me termet llogarites me periode kthimi 475vjet. Rezultatet e analizave sipas Eurokodeve jepen ne vazhdim.

Sipas kushteve europiane te projektimit jane zgjedhur parametrat e ngarkimit sizmik  $PGA=0.25g$  dhe te sjelljes se strukture (shih haren e  $PGA$  ne kapitullin 3.3 dhe aneksin). Spektri i reagimit elastik dhe llogarites jepet ne figuren me poshte. Koeficienti i sjelljes se strukture eshte marre sipas EC8/1,  $q=3$ . Procedura e percaktimit te "q" jepet ne aneks.




Figure 7. Spektri i reagimit elastik dhe llogarites per  $q=3.1$

Spektri i zhvendosjeve jepet ne figuren me poshte. Theksojme se sipas kodeve zhvendosja kufizohet tej perodeses se cepit  $T_D=2s$ .




Figure 8. Spektri i zhvendosjeve llogaritese

Aspektet e modelimit struktural dhe percaktimi i veprimit sizmik të dhene me sipër janë bërë në bazë të kushteve të Eurokodit 8. Kombinimi i ngarkesave sizmike dhe veprimeve të tjera është bërë duke u bazuar në EC1.

Elementet e strukturës janë modeluar me anë të elementeve shufër (frame), mure plane (shell) dhe soleta diafragma rigjide në planin e vet. Kontributi i elementeve jo strukturor është neglizhuar.

Per shkak të formës së strukturës është zgjedhur model 3D nën ngarkesa vertikale dhe veprimin e termetit. Modeli për llogaritje sizmike është zgjedhur analize modale me spekter reagimi, me masa të përqendruara në qendrën e masës (i përqendron vetë programi) dhe jashtëqendërsi aksidentale 5% sipas çdo drejtimi. Për qëllime praktike janë zgjedhur vetëm 20 forma lekundje dhe janë kombinuar me anë të rregullit CQC pasi vlerat e periodave janë të afërta.

Modeli dhe rezultat e analizave paraqiten më poshtë.

### Rezultatet analizës sizmike të modelit linear sipas software-it "Autodesk Robot Structural Analysis".

Modeli i analizës lineare për strukturën kryesore.




Figure 9. Modeli sipas software-it "Autodesk Robot Structural Analysis".

Periodat e lekundjeve vetjake, masave pjesemarrrese etj jepen ne tabelen ne vazhdim.

Table 3. Rezultatet e analizes modale

Case/Mode	Frequency (Hz)	Period (sec)	Rel.mas.UX (%)	Rel.mas.UY (%)	Rel.mas.UZ (%)	Cur.mas.UX (%)	Cur.mas.UY (%)	Cur.mas.UZ (%)	Total mass UX (kg)	Total mass UY (kg)	Total mass UZ (kg)
3/ 1	0.35	2.88	0.00	73.94	0.0	0.00	73.94	0.0	13037333.59	13037333.59	0.0
3/ 2	0.40	2.52	0.00	75.40	0.0	0.00	1.46	0.0	13037333.59	13037333.59	0.0
3/ 3	0.46	2.18	78.95	75.40	0.0	78.95	0.00	0.0	13037333.59	13037333.59	0.0
3/ 4	1.24	0.80	78.95	83.31	0.0	0.00	7.91	0.0	13037333.59	13037333.59	0.0
3/ 5	1.33	0.75	89.72	83.49	0.0	10.77	0.18	0.0	13037333.59	13037333.59	0.0
3/ 6	1.33	0.75	92.95	84.01	0.0	3.23	0.51	0.0	13037333.59	13037333.59	0.0
3/ 7	2.16	0.46	98.54	84.01	0.0	5.59	0.01	0.0	13037333.59	13037333.59	0.0
3/ 8	2.21	0.45	98.54	95.16	0.0	0.01	11.15	0.0	13037333.59	13037333.59	0.0
3/ 9	2.31	0.43	98.56	95.98	0.0	0.01	0.82	0.0	13037333.59	13037333.59	0.0
3/ 10	2.89	0.35	99.48	95.98	0.0	0.93	0.00	0.0	13037333.59	13037333.59	0.0

Pozicionet e qendrave te masave, te shtangesise, zhvendosjet dhe driftet jepen ne tabelat dhe figurat ne vazhdim.

Table 4. Rezultat e analizes strukturale. QM, QSh, jashteqendersite

Case/Story	Name	Mass (kg)	G (x,y,z) (m)	R (x,y,z) (m)	Ix (kgm2)	Iy (kgm2)	Iz (kgm2)	ex0 (m)	ey0 (m)	ex2 (m)	ey2 (m)
5/ 1	Story 1	3803069.53	29.91 17.88 5.0	30.01 17.92 5.0	413370627.47	1214097133.73	1618403953.76	0.10	0.05	3.00	1.79
5/ 2	Story 2	1841174.05	29.58 17.85 10.	30.02 17.93 10.	56853383.94	579456395.38	635205247.35	0.44	0.07	3.00	0.99
5/ 3	Story 3	1897974.88	29.61 17.86 14.	30.02 17.93 14.	58261504.09	589325914.19	646472956.09	0.41	0.07	3.00	0.99
5/ 4	Story 4	1897974.88	29.61 17.86 19.	30.02 17.93 19.	58261504.09	589325914.19	646472956.09	0.41	0.07	3.00	0.99
5/ 5	Story 5	1897974.87	29.61 17.86 23.	30.02 17.93 23.	58261504.12	589325917.58	646472959.51	0.41	0.07	3.00	0.99
5/ 6	Story 6	1872835.08	30.07 17.96 27.	30.02 17.93 27.	58439955.82	595920042.32	653243642.97	0.04	0.03	3.00	0.99

Table 5. Rezultat e analizes strukturale. Zhvendosjet dhe driftet

Case/Story	UX (cm)	UY (cm)	dr UX (cm)	dr UY (cm)	d UX	d UY	Max UX (cm)	Max UY (cm)	Min UX (cm)	Min UY (cm)
4/ 1	7.3	0.3	7.3	0.3	0.01	0.00	7.1	2.4	6.6	0.1
4/ 2	13.5	0.8	6.3	0.5	0.01	0.00	13.7	4.7	13.0	0.3
4/ 3	18.5	1.3	5.0	0.4	0.01	0.00	19.4	5.3	17.8	0.4
4/ 4	23.7	1.5	5.2	0.3	0.01	0.00	24.8	3.4	22.8	0.2
4/ 5	26.9	1.7	3.2	0.2	0.01	0.00	28.2	4.2	26.0	0.3
4/ 6	28.7	1.8	1.7	0.1	0.00	0.00	29.9	6.2	27.6	0.5
5/ 1	0.2	6.9	0.2	6.9	0.00	0.01	0.7	7.1	0.4	6.8
5/ 2	0.5	18.3	0.3	11.3	0.00	0.03	1.4	18.6	0.6	18.0
5/ 3	0.7	28.0	0.2	9.7	0.00	0.02	1.9	28.7	0.5	27.4
5/ 4	0.9	33.3	0.1	5.3	0.00	0.01	2.2	34.2	0.1	32.7
5/ 5	1.0	36.7	0.1	3.5	0.00	0.01	2.5	37.8	0.3	36.1
5/ 6	1.1	38.9	0.1	2.1	0.00	0.00	2.7	40.0	0.5	38.1






Figure 10. Pozicionet e QM dhe QSh per katin tip




Figure 11. Pozicionet e QM dhe QSh per katin e gjashte




Figure 12. Zhvendosjet sipas drejtimit x.




Figure 13. Zhvendosjet sipas drejtimit y.

Forcat e brendeshme sipas kombinimeve kryesore per analizat pa murature jane perdorur per llogaritjet ne beton sipas EC2 dhe EC8/1. Rezultat e armimeve jepen ne figurat me poshte.




Figure 14. Armimi i elemeneve.

Sipas analizes lineare kontrollin e armimit ekzistuese me ate te kerkuar nga analiza duhet ta realizojme manualisht meqenese ne software nuk kemi futur armim te elemeneve.

Ne baze te krahasimit rezulton qe:

- Taret ne mbeshtetjet e anes nuk kane armimin e duhur gjatesor dhe terthor.
- Disa kollona ne katet 0,1 duhet tu rritet rezistenca ose ndryshuar seksioni.
- Kollonat kane armimin e duhur gjatesor por nuk kane rrezerve te kenaqshme per ngakim dyaksial dhe nuk kane armimin e duhur terthor sidomos ne zonat kritike.
